

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 640/20
Datë/Datum. 07/09/2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNES SE GJAKOVES

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 632-20-3153-1-2-1

Sa i përket tenderit për Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

DWH-KOSOVA SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Hilmi Rakovica 13

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+37744779379

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Selvete Gagica

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Leta.gagica@dwh-solution.com

(Adresa elektronike)

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

(Adresa)

(Vendi)

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike)

07.09.2020



(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Date, 31.08.2020 Rihapja e tenderit

Date, 31.08.2020 Kerkese per informacione shtese

Date, 02.09.2020 Ripublikimi i dates se dorezimit te dosjes

Date, 02.09.2020 Pergjigja e kerkeses per infomacione shtese

Date, 03.09.2020 Kerkesa per Rishqyrtim

Date, 04.09.2020 Refuzimi i kerkeses per rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☒

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

nenet e shkelura:

Neni 1
Neni 7
Neni 10

Neni 28

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK ne kundërshtim të hapur me LPPn04/L-42 si germe dhe fryme, si dhe ne mosrespektim të vazhdueshëm dhe kokoret me vendimet e një pasnjeshme të OSHP (!), kundërshton të vendosë tenderin në shtratin ligjor dhe të bëjë transparence.

Pyetjeve tona të thjeshta, direkte dhe nominale, i bishtnon Kërkesat tona, i deformon dhe pastaj debaton me deformimin e vetkrijuar.

Bazuar në eksperiencën tashme disavjecare me AK, si dhe për të krijuar një pamje të qartë për OSHP, Ekspertin Shqyrtes (ESH), AK dhe OE (neve), po e presantojmë problematiken me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme edhe për një nxenes të klases së 4-te.

Parantese.....

AK kërkon të blejë GPS dhe Stacion Total.

GPS, është një instrument që realizon matjen e një pike të caktuar (në plan dhe kuotë) në terren, nëpërmjet sinjaleve satelitore.

GPS është një antenë, e cila në vetvete ka një board (marres), i cili regjistron sinjalet satelitore.

Informacionin që fiton GPS, në e lexojmë me ndihmën e një instrumenti ndihmes, i cili është një lloj telefoni/tableti telefonik, i cili bën leximin e matjeve të GPS. Ky telefon/tablet quhet kontrollor. GPS punon me dhe pa kontrollor.

GPS duhet të realizojë matje të sakta dhe të sigurta. Saktësia dhe siguria e matjeve varet ekskluzivisht dhe 100% nga performanca e GPS.

Kontrollori nuk ka asnjë rol në performancën e GPS. Kontrollori as përmireson dhe as përkeqëson dot performancën e GPS.

Po të bëjmë një krahasim me teknologjinë e automobilit, kontrollori ka idenë me bordin e karrigës, i cili nuk ka asnjë rol në performancën e karrigës (as në fuqinë motorike, as në stabilitetin në lëvizje, as në kursimin e lëndës djegëse etj, etj).

Stacioni Total është një instrument mates, si edhe GPS, që realizon matje (plan dhe

kuote) ne terren, por me nje tjeter metode, ku nuk nevoiten sinjalet satelitore.

Si edhe me lart spiegotet, per te mundesuar blerjen e nje GPS dhe Stacion Total me performance te larte, nevoitet te percaktohen kerkesa te larta teknike.

....mbyllim parantesen.

Cfare ndodh me AK ne kete tender?

AK ka vendosur kerkesa minimale dhe fare anesore per GPS dhe Stacion Total. Pra si produktet fare pa cilesi edhe produktet me cilesi "e kane deren te hapur ne tender". Deri ketu cdo produkt i dobet do te kishte 100% mundesi te fitonte tenderin me nje cmim prej 1000€.

AK ne menyre hilegare, ka vendosur kerkesa te cudithme vetem per kontrollerin (pjesen periferike dhe pa efekt performance), ne menyre qe produkti fitues te percaktohet nga kontrolleri dhe jo nga GPS apo Stacioni Total.

AK ka vendosur per KONTRLLERIN, kerkesa

1. te kufizuara (sistem operativ: windows)
2. te tejkaluara (memorja 64GB), dhe
3. qellimboshe (IP68)

Para se te spiegojme, secilen nga keto kerkesa te percudnuara, po ndalemi te kerkesa e pare qe ne i kemi bere AK, dhe ne pergjigjen shokuese dhe kunderligjore te saj.

Ceshtja pare: Metoda e vleresimit te tenderit

Pyetjes sone, si do te vleresohen ofertat teknike, financiare dhe tekniko-financiare?

AK, ne leter-pergjigjen e vet, date 02.04.2020 shprehet "cmimi me i lire".

Kjo pergjigje bie ndesh me aneksin 6, dosja tenderit.

Por edhe me Nenin 28, pika 4 (standarti europian, ne te cilin eshte bazuar edhe aneksi 6, dosja e tenderit).

Sipas aneksit 6, dosja e tenderit dhe nenit 28 pergjigja duhet te ishte "oferta me e lire e pergjegjshme".

Por qe te jete e pergjegjshme, rezulton nga vleresimi teknik sipas formulave te aneksit 6.

Dhe qe te jete me lire dhe e pergjegjshme rezulton nga vleresimi financiar dhe tekniko-financiar, sips Aneksit 6.

Por AK, me pergjigjen e saj, date 02.09.2020, deklaroi qe nuk do te bazohet as ne aneksin 6 dhe as ne nenin 28.

I kerkojme OSHP dhe ESH, te prapsoje vendimin e AK, duke e vendour ate ne anen e ligjes.

Ceshtja dyte: Kontrolleri, Sistemi Operativ EKUIVALENT

AK percaktohet ne nje produkt periferik, kontrollerin, dhe kerkon sistem operativ: Windows.

Pra kerkon vetem nje zgjidhje, duke perjashtuar zgjidhjet e tjera ekuivalente, si edhe eshte Android, IOS etj.

Kjo bie ndesh me nenin 28, Pika 6 (zgjidhje ekuivalente), si dhe me vendimin e OSHP 458/20, date 20.08.2020.

Kjo bie ndesh edhe me nenin 1 dhe 7

AK ben nje akrobaci te papare dhe degjuar, duke deklaruar nje sistem operativ te caktuar "windows", ekuivalent me vetveten "windows", (versionin 10, 8, 7, etj)

AK ngaterron qellimisht nocionin "VERSION" me nocionin "EKUIVALENT". Pra AK ben edhe nje zbulim leksikologjik jo vetem ne gjuhen shqipe, por edhe ne gjuhet e tjera te botes, ku nocionet "ekuivalent" dhe "version" i shpall sinonime?!

Nuk dime, nese AK e ka depozituar kete zbulim ne akademine e shkencave te Kosves apo jo? Por per sa kohe ky zbulim nuk eshte pranuar dhe miratuar nga Departamenti i Gjuhesise e Akademise se Shkencave te Kosoves, ne jemi te detyruar ti permbahemi leksikut ne fuqi te gjuhes shqipe, sipas te cilit Ekuivalent nuk eshte sinonim e Versionit.

AK ne leter-pergjiqjen e saj, date 02.09.2020, justifikon kerkesen e windows (pra AK pranon qe ka ngushtuar garen ne nje sistem) me "nevojen per te instaluar nje software te trete" ne kontrollor (windows). Por AK kete software te trete prej vitesh (edhe ne tenderat paraprak) e mban sekret, nuk e tregon se cili eshte(?1), edhe pse ligji kerkon transparence.

Por ne leter-refuzimin, date 04.09.2020 AK me ne fund (eureka!) zbulon qe ky software eshte AutoCAD.

Me kete pergjigje AK kapet ne flagrance profesionale, pasi - e para, nuk eshte pare e degjuar te instalohet AutoCAD ne Kontrollor. Ky do te ishte nje "zbulim shkencor" per te qithe boten, pasi AutoCAD eshte software zyre, dhe per me teper SW i rende dhe nuk instalohet ne Kontrollor, pasi perndryshe kontrolleri ne fushe as qe do te mund te ngrihej ne gjendje pune, dhe

- e dyta, te dhenat e matjes ruhen ne SW e punes dhe jo ne sistemin operativ (qofte ky windows, android, IOS etj).

Pergjigja e AK eshte jo profesionale, jo serioze, por loje fjalesh, me shprese qe ESH apo OSHP do te mund te manipulohej ne loje fjalesh gjoja teknike.

Keshtu qe matjen e bere ne nje Kontrollor/Tablet/Phone me sistem operativ Android, IOS etj mund te kalohen me nje klik nga formatet e SW te punes (si psh dxf, txt. etj) ne AutoCAD, sic ndodh random nga cdo kontrollor. Transferimi i te dhenave nga Kontrolleri ne AutoCAD nuk varet asfare nga sistemi operativ i kontrollorit.

I kerkojme OSHP dhe ESH te mund te kthjelloje AK qe windows, android, IOS etj jane sistem operative ekuivalente, kurse windows 10, 8 apo 7 jane versione te ndryshme te te njetit sistem operativ.

Ceshtja trete: Kontrolleri Memorja 64GB dhe IP68

AK vazhdon me nje kerkese te vjeter dhe te pazakonte, perseri te Kontroller-i, qe eshte Memorja 64GB.

Ne vitet 1990 deri ne vitet 2000 memorja e kontrollerit ishte vetem e brendshme. Por pas viteve 2000 dolen ne treg memorjet mobile, si USB, SD-Card, te cilat gjenden ne kapacitete te vogla deri ne kapacitete shume te larta. Nisur nga nje zhvillim i madh i memorjeve mobile, kontrollerat filluan te prodhohen me memorje te ulet, qje qe ul stresin e panevojshem ne kontroller. Sot mbi 99% e kontroller-ve ofrohen me memorje te brendshme te ulet, por te gjitha kane SLOT, ku vendoset memorje mobile (SD-CARD, USB, Mini-USB) me kapacitete te larta. Kontroller alphanumerik me memorje 64GB, eshte qje e rralle, dhe kryesisht teknologji e vjeter.

Kjo kerkese e AK, eshte e vjeter, nuk i pergjigjet produkteve te kohes, eshte kufizim dhe e pajustifikuar. Ky eshte nje nga "kurthet", qe AK krijon per te shmangur garen.

Ne i kerkojme AK, qe te na coje nje liste me Datasheet-et e produkteve, qe plotesojne keto specifikime, por AK ka cuar nje liste te emrave te prodhuesve, kontroller-at e te cileve, me perjashtim te nje prodhuesi Topcon-Sokkia nuk i plotesojne (bile Ak ne menyre te cuditshme prodhuesin e vetem Topcon-Sokkia, i paraqet si dy prodhues te ndryshem?!).

Po keshtu AK kerkon per Kontroller-in IP68, por GPS vehte (produkti kryesor) nuk ka IP68, po keshtu Stacioni Total kerkohet me IP66, pra me te ulet.

Nese IP 66 apo 67, do te ishte e pamjaftueshme, atehere kur GPS dhe Stacioni, qe jane me te ekspozuar se Kontrolleri ndaj mjedisit, nuk do te mund te funksiononin (per efektin e IP), per cfare do na duhej Kontrolleri kur GPS dhe Stacioni nuk punon?

I kerkojme OSHP dhe ESH, ti spegojne AK, qe perzgjedhja akrobatike eshte ne kundërshtim me LPP 04/L-042.

Po keshtu i kerkojme OSHP dhe ESH, qe te detyrojne AK, te na beje me dije datasheetet e prodhuesve te ndryshem, qe Ak disponon, ku specifikimet e kerkuara nga AK permbushen (eshte detyre e AK te sigurojne gara te hapur).

Ceshtja katert: Sinjalet satelitore

Ne pyesim AK prej fillimit, me kembengulje dhe ne menyre specifike, per sinjalet satelitore, por AK i bishton pyetjes, dhe nuk pergjigjet thjeshte dhe direkt me po apo jo!!!

Perse?

Sepse GPS i "perzgjedhur nga AK", nuk i ka te gjitha sinjalet, sidomos sinjalet e reja: L5 (GPS), L3 (Glonass), E6 (Galileo) dhe B3 (BDS).

Perse eshte e pamundur qe AK te pergjigjet te sinjalet Po(?), sepse do ti pamundesonte GPS te paracaktuar te fitonte garen (sepse nuk ka performancen e shumices se GPS te tjere)

Perse eshte e pamundur qe AK te pergjigjet te sinjalet ne krah Jo(?), sepse do te dilte zbuluar selektimi i sinjaleve bazuar ne GPS e paracaktuar.

AK, duke u gjendur ne nje pozicion te veshtire, nuk jep pergjigje, por hyne ne debate fjalesh, "pa arte dhe parte".

Ne shpresojme, qe OSH dhe ESH, do te mund ti marre AK, nje pergjigje te paster, transperente dhe te shkurter, per secilin sinjal te kerkuar nga neve.

L5-GPS: Po apo Jo

L3-Glonass: Po apo Jo

A6-Galileo: Po apo Jo

B3-BDS: Po apo Jo

Ceshtja e peste: Burimi i te dhenave per AK

Ne i kemi kerkuar AK burimin e te dhenave, ku AK eshte mbeshtetur per te perzgjedhur specifikimet e botuara.

Ne i kemi marre me radhe te tere produktet (Kontrollerat), e prodhuesve te rreshtuar nga AK, dhe rezultati eshte si vijon:

Leica ka 4 Controller ne program, dhe asnje nuk ploteson kerkesat e AK

<https://leica-geosystems.com/products/gnss-systems/controllers>

Topcon ka 2 Kontroller ne program dhe asnje nuk ploteson kerkesat e AK

<https://www.topconpositioning.com/field-controllers>

Trimble ka 2 Kontroller ne program dhe vetem njeri ploteson kerkesat e AK

<https://geospatial.trimble.com/data-collectors>

Sokkia ka 3 Kontroller ne program dhe asnje prej tyre nuk ploteson kerkesat e AK

<https://eu.sokkia.com/de/produkte/software-und-feldrechner>

Hi-Target ka 3 Kontroller ne program dhe asnje prej tyre nuk ploteson kerkesat e AK

<http://en.hi-target.com.cn/product/prodetail.aspx?pid=10266>

GeoMax ka 3 kontroller ne program dhe asnje nuk ploteson kerkesat e AK.

<https://geomax-positioning.com/de-de/products/field-controllers>

Burimi i informacioneve tona: Webpage te prodhuesve te mesiperme, Datasheet - Contoillers

Rezultati: Burimi i dhene nga AK, rezulton, qe nuk gjenden kontroller - me nje perjashtim te vetem - qe permbushin specifikimet e kerkuara nga AK?!

Shenim: Prodhuesi Topcon - Sokkia, duhet marre me rezerva, pasi bazuar ne eksperiencen tone, OE i Topcon-Sokkia eshte aktiv ne tendera edhe me produkte te vjetra, te dala nga prodhimi prej vitesh. Duke pare qe edhe kerkesat e AK bazohen ne produkte te vjetra, nje gje e tille behet edhe me probable.

Burimi i informacionit te dhene nga AK rrezon vehte pretendimet e AK, duke rrezultuar desinformim i qellimshem (!), ne rast se nuk eshte diksuh tjetër jashte AK, qe pregatit letrat per AK (?!).

Ak duhet ti spiegoje OSHP dhe ESH, si eshte e mundur dhe perse ky desinformim?

KERKESE PER OSHP:

Ne i kerkojme OSHP qe te vendose kete tender ne shtratin ligjor, duke e detyruar AK, te respektojë LPP 04/L-042, Neni 1, 7, 10 dhe 28, duke e hapur tenderin konform kerkeses se LPP.

Specifikimet e me poshtme duhet te hapen si vijon

Sistemi operativ: Windows, Android ose IOS
Memoria 64GB: e brendshme ose e jashtme
IP: sa e GPS ose Stacionit Total

Punoi: Dipl.Ing. Selvete Gagica

Keshilla juridike: Av. Ali Beka

Keshilla teknike: Dipl.Ing. Muzaffer Mustafa

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**

NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ PUNË☒ FURNIZIM☐ SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: **25.06.2020**

Nr i Prokurimit	632-20-3153-1-2-1
Nr i brendshëm	632-20-044-121

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KOMUNA E GJAKOVËS		
Adresa Postare: Rr "Nënë Tereza"		
Qyteti: GJAKOVË	Kodi postar: 50000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Faton Gutaj		Telefoni: 038-200-44041
Email: faton.gutaj@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://kk.rks-gov.net/gjakove		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifikoj identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoj një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS